

GEFF - Ballkani Perëndimor - AFK

II

Vendi:
Kosovë

Numri i Projektit:
52958

Sektori i aktivitetit:
Institucionet financiare

Lloji i njoftimit:
Private

Kategoria mjedisore:
FI

Data e miratimit:
15 Qer 2021

Statusi:
Disbursim

PSD e shpallur:
11 Qer 2021

Sipas kreut 1.4.2 (iii) të Direktivës për Qasjen në Informacion: "Për projektet e miratuara nga menaxhmenti i Bankës ku Bordi i Drejtorëve ka deleguar autorizimin e miratimit, PSD-ja shpallet në fillim të periudhës përkatëse të njoftimit të dhënies pa kundërshtime një vendi anëtar të Bankës në përputhje me nenin 13 (iii) të Marrëveshja për Themelimin e BERZH-it."

Përshkrimi i Projektit

Një kredi seniore e pasiguruar deri në 2 milionë euro, e dhënë në dy transhe të barabarta, në kuadër të Instrumentit Financiar të Ekonomisë së Gjelbër të Ballkanit Perëndimor (BB GEFF). Transha e dytë është e pazotuar, ndërsa zotimi i saj bëhet vetëm në diskrecion të plotë të BERZH-it.

Objektivat e Projektit

Transaksioni mbështet investimet në teknologji, materiale dhe zgjidhje me efikasitet energjie e performancë të lartë, të ndërmarra apo të zbatuara në ose në lidhje me, banesat ose ndërtesat e banimit në pronësi private ("sub-projektet") në Kosovë. Sub-

projektet përzgjidhen sipas kriterëve të përshtatshmërisë teknike dhe financiare të parapara në deklaratën e politikave për BB GEFF. 100% e përdorimit të fondeve do të lidhet me investimet e Tranzicionit drejt Ekonomisë së Gjelbër.

Ndikimi tranzicional

Nota ETI 80

Projekti kontribuon në objektivat e përgjithshme të WB GEFF, duke mbështetur cilësinë e NT-së së Gjelbër dhe Konkurruese.

Gjelbër: Projekti do të kontribuojë në ndërtimin e një ekonomie të gjelbër duke mundësuar zgjerimin e kreditimit për investime në teknologjitë e ekonomisë së gjelbër banesore, me performancë të lartë dhe efekte pozitive demonstruese të projekteve të ekonomisë së gjelbër.

Konkurruese: Projekti do të kontribuojë në ndërtimin e një sektori financiar më konkurrues përmes zhvillimit të kapaciteteve të brendshme të institucioneve financiare partnere për financimin e projekteve të ekonomisë së gjelbër.

Informatat për Klientin

AGJENCIA PËR FINANCIM NË KOSOVË

Agjencia për Financim në Kosovë ("AFK") është institucioni i katërt më i madh mikrofinanciar ("IMF") në Kosovë, organizuar si organizatë joqeveritare ("OJQ"). Themelimi i saj është financuar nga kontributet e siguruara përmes Mercy Corps, OJQ me seli në SHBA. Me operimin e saj që nga tetori i vitit 2000, AFK ofron qasje në financa për sipërmarrësit mikro dhe të vegjël, veçanërisht në zonat rurale.

Përmbledhja e Financimit nga BERZH

EUR 2,000,000.00

Kostoja totale e Projektit

EUR 2,000,000.00

Shtueshmëria

Shtueshmëria arrihet duke kombinuar financimin e nevojshëm afatgjatë, në formën e një kredie seniore, me mbështetje teknike dhe stimuj të shënjestruar për investime në një pako që promovon investimet e ekonomisë së gjelbër banesore në Kosovë.

Përmbledhje mjedisore dhe sociale

IF e kategorizuar (ESP 2019). AFK është klient ekzistues dhe do të obligohet të vazhdojë respektimin e procedurave PR 2, 4 dhe 9, të zbatojë Procedurat e Menaxhimit të Riskut E&S të BERZH-it për Kreditë Korporative, NVM-ve dhe Mikro-

ndërmarrjeve, duke përfshirë respektimin e listës së zgjeruar të përjashtimeve BERZH E&S, si dhe Listës së Referimeve, të vendosur me ESP 2019, si dhe të dorëzojë raportet vjetore për E&S në Bankë. Sipas GEFF të BB-së, për shkak të natyrës së projektit që shënjestron sektorin banesor, si dhe strukturës së harmonizuar të aprovimit, të gjitha sub-projektet që janë në përputhje me Selektorin Teknologjik kualifikohen automatikisht (me përjashtim të nën-kredive për ofruesit e shërbimeve, shitësit, prodhuesit). Nën-kreditë për ofruesit e shërbimeve, operatorët, prodhuesit i nënshtrohen shqyrtimit nga një Konsulent Projekti dhe kontrollohen kundrejt kërkesave të kualifikimit të GEFF-së. Të gjithë nën-projektet duhet të jenë në përputhje me legjislacionin vendor në fuqi për mjedisin, çështjet sociale, shëndetësore dhe të sigurisë.

Bashkëpunimi Teknik dhe Financimi i Granteve

TC: 5.1 milionë euro për Instrumentin e përgjithshëm për të mbështetur përgatitjen, zbatimin dhe monitorimin e BB GEFF. AFK-ja në parim është pajtuar që të ndajë deri në 15% të kostove të TC nga të cilat përfitojnë drejtpërdrejt. Lloji i kontributit do të përcaktohet në Marrëveshjen e Kredisë. Shuma e saktë duhet të përcaktohet gjatë zbatimit të projektit. Mjetet e grantit sigurohen nga Republika e Austrisë dhe Korniza e Investimeve e Ballkanit Perëndimor, financuar nga shumë donatorë, për të financuar programin TC në kuadër të GEFF.

Non-TC: 410,500 euro (për këtë projekt) për stimuj investimi për nën-kreditorët për zbatimin e nën-projekteve të kualifikuara në përputhje me Deklaratën e Politikave. Fondet e grantit sigurohen nga Bashkimi Evropian.

Projekti TC me Këshillimin e BERZH për Biznesin e Vogël (ASB): Si projekt i veçantë, AFK-ja pritet të pranojë ndihmë me grante deri në 30 mijë euro nga ASB, për t'i mbështetur ato me planifikim strategjik dhe të biznesit.

Informata kontakti të Kompanisë:

Vahdet Anadolli

VAnadolli@afkonline.org

+383 39 424 242

www.afkonline.org

Agjencioni për Financim në Kosovë (AFK) Lidhja e Prizrenit Nr.1 Pejë Republika e Kosovës

PSD është përditësuar së fundi

11 Qer 2021

Të kuptuarit e Tranzicionit

Informacione të mëtejshme në lidhje me qasjen e BERZH-it për matjen e ndikimit të tranzicionit mund të gjenden [këtu](#).

Mundësi biznesi

Për mundësi biznesi ose prokurime, kontaktoni kompaninë kliente.

Për mundësi biznesi me BERZH (jo lidhur me prokurimin) kontaktoni:

Tel: +44 20 7338 7168

Email: projectenquiries@ebrd.com

Për projektet e sektorit shtetëror, vizitoni [Prokurimin e BERZH](#) :

Tel: +44 20 7338 6794

Email: procurement@ebrd.com

Pyetje të përgjithshme

Kërkesa specifike mund të bëhen duke përdorur [formularin e pyetjeve të BERZH-it](#).

Politika Mjedisore dhe Sociale (ESP)

[ESP](#) dhe kriteret përkatëse të performancës (PRs) shtjellojnë mënyrat në të cilat BERZH-i implementon zotimet e saj për të promovuar "zhvillimin e shëndoshë e të qëndrueshëm në aspektin mjedisor". ESP dhe kriteret (PR) përmbajnë dispozita specifike për klientët që të respektojnë kriteret e zbatueshme të ligjeve vendore për informimin dhe konsultimin publik, si dhe për të krijuar një mekanizëm ankesash për të pranuar dhe mundësuar zgjidhjen e brengave dhe ankesave të palëve të interesit, në veçanti, për performancën mjedisore dhe sociale e klientit dhe e projektit. Në proporcion me natyrën dhe shkallën e rreziqeve dhe ndikimeve mjedisore dhe sociale të projekteve, BERZH-i kërkon gjithashtu që klientët e saj të shpalosin informata, sipas rastit, në lidhje me rreziqet dhe ndikimet që rrjedhin nga projektet, ose të ndërmarrin konsultime domethënëse me palët e interesit dhe të marrin në shqyrtim e të reagojnë ndaj përgjigjeve të tyre.

Më shumë informata mbi praktikën e BERZH-it në këtë drejtim ofrohen tek [ESP](#).

Integriteti dhe Pajtueshmëria

Zyra e Kryezyrtarit të Pajtueshmërisë në BERZH (OCCO) promovon qeverisjen e mirë dhe siguron që standardet më të larta të integritetit të zbatohen në të gjitha aktivitetet e Bankës, në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare. Hulumtimi i thuktë i integritetit bëhet për të gjithë klientët e Bankës, për të siguruar që projektet të mos paraqesin rreziqe të papranueshme për integritetin ose reputacionin për Bankën. Banka beson se identifikimi dhe zgjidhja e çështjeve në fazat e miratimit të vlerësimit të projekteve është mjeti më efektiv për të garantuar integritetin e transaksioneve të Bankës. OCCO-ja luan rol kyç në këto përpjekje mbrojtëse dhe gjithashtu ndihmon në monitorimin e rreziqeve të integritetit në projekte pas investimit.

OCCO-ja është gjithashtu përgjegjëse për hetimin e pretendimeve për mashtrim, korrupsion dhe kundërvajtje tjera në projektet e financuara nga BERZH. Çdokush, brenda ose jashtë Bankës, që dyshon për mashtrim ose korrupsion, duhet të dorëzojë raport me shkrim tek Kryezyrtari i Pajtushmërisë me email tek compliance@ebrd.com. Të gjitha çështjet e raportuara trajtohen nga OCCO-ja në vazhdimësi. Të gjitha raportet, përfshirë ato anonime, shqyrtohen. Raportet mund të bëhen në çdo gjuhë të Bankës ose të vendeve ku Banka operon. Informatat e dhëna duhet të raportohen në mirëbesim.

Politika për Qasjen në informata (AIP)

AIP përcakton mënyrën se si BERZH shpalos informatat dhe konsulton palët e veta të interesit ashtu që të promovojë vetëdije më të lartë dhe kuptueshmëri të strategjive, politikave dhe operacioneve të tij pas hyrjes në fuqi më 1 janar 2020. Ju lutemi vizitoni faqen e [Politikës për Qasje në informata](#) për të parë se cilat informata janë në dispozicion tek faqja e internetit e BERZH-it.

Kërkesa specifike për informata mund të bëhen duke përdorur [formularin e pyetjeve të BERZH-it](#).

Mekanizmi i pavarur i llogaridhënies së projektit (IPAM)

Nëse përpjekjet për shqyrtim të brengave mjedisore, sociale ose publike me Klientin ose Bankën janë të pasuksesshme (p.sh. përmes mekanizmit të ankesave të nivelit të projektit të Klientit apo përmes angazhimit të drejtpërdrejtë me menaxhmentin e Bankës), individët dhe organizatat mund të përpiqen të parashtrojnë brengat e tyre nëpërmjet Mekanizmit të pavarur për llogaridhënie të projektit (IPAM) në BERZH.

IPAM shqyrton në mënyrë të pavarur çështjet e Projektit që besohet të kenë shkakuar (ose kanë pasur gjasë të shkaktojnë) dëm. Qëllimi i Mekanizmit është: të mbështesë dialogun midis palëve të interesit të Projektit për të zgjidhur çështjet mjedisore, sociale dhe publike; të përcaktojë nëse Banka ka respektuar [Politikën e saj Mjedisore dhe Sociale](#) ose dispozitat specifike lidhur me Projektin të [politikës për qasje në informata](#); si dhe në rastet e caktuara, të trajtojë çdo mospërputhje ekzistuese me këto politika, duke parandaluar mungesën e pajtushmërisë në të ardhmen nga ana e Bankës.

Ju lutemi vizitoni faqen e internetit të [Mekanizmit të Pavarur të Llogaridhënies së Projektit](#) për të mësuar më shumë rreth IPAM-së dhe mandatit të tij; si të [paraqitet kërkesa](#) për shqyrtim; ose të kontaktoni IPAM-në përmes emailit ipam@ebrd.com për të marrë udhëzime dhe më shumë informata për IPAM-në dhe mënyrën e paraqitjes së kërkesës.